



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 korrik 2019

Nr. Ref.:RK 1398/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI36/18

Parashtrues

Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 98/2017, të 19 tetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga shoqëria aksionare Limak Kosovo International Airport J.S.C. “Adem Jashari”(në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, komuna e Lipjanit, të përfaqësuar me autorizim nga Fazli Gjonbalaj dhe Leonora Fejzullahu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin Rev. nr. 98/2017, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 19 tetorit 2017, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 15 nëntor 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-indryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 mars 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 13 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani (anëtarë).
8. Më 22 mars 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendim për zëvendësimin e gjyqtarit raportues dhe në vend të gjyqtarit Altay Suroy si gjyqtar raportues u caktua gjyqtari Bekim Sejdiu.
12. Më 11 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Radomir Laban dhe Gresa Caka-Nimani (anëtarë).
13. Më 13 shtator 2018, në pajtim me rregullin 40 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18.
14. Më 13 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për bashkimin e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18.
15. Më 14 shtator 2018, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin dhe bashkimin e rasteve dhe kërkoi nga ta që të dorëzonin në Gjykatë fletëkthesat lidhur me lëndët: KI36/18, KI81/18, KI82/18 dhe KI124/18.
16. Më 1 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesat e kërkuara.
17. Më 17 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë në Gjykatë, ku kërkoi që kërkesa me nr. KI109/18 të shqyrtohet ndaras nga kërkesa me nr. KI36/18, duke pretenduar se rastet nuk janë të së njëjtës natyrë.
18. Më 5 prill 2019, Gjykata shqyrtoi dhe miratoi kërkesën e parashtruesit lidhur me ndarjen e kërkesës KI109/18 nga kërkesa me numër KI36/18. Po ashtu, Gjykata në përputhje me rregullin 40 (3) të Rregullores së punës vendosi që kërkesat KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18 të shqyrtohen ndaras.
19. Më 11 prill 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për ndarjen e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18.
20. Më 12 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë të titulluar "[...] lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese dhe në veçanti për lëndën e regjistruar me [...] numër KI132/18" si dhe bashkëngjiti në Gjykatë Marrëveshjen e Partneritetit Publiko-Privat (në tekstin e mëtejme: PPP).
21. Më 16 maj 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një parashtrësë të titulluar "*Parashtrësë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën*

Kushtetuese”, në të cilën ai në thelb i përsëriti pretendimet që kishte bërë më parë.

22. Më 20 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

23. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës kishin nënshkruar një Marrëveshje të Partneritetit Publiko-Privat (në tekstin e mëtejme: MPPP). Para marrëveshjes së MPPP-së, Aeroporti i Prishtinës u quajt Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” (në tekstin e mëtejme: ANP).
24. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se N. D. (në tekstin e mëtejme: punëtori) kishte qenë i punësuar tek ANP-ja. ANP dhe punëtori kishin lidhur kontratë pune në kohë të caktuar, duke filluar nga 1 korriku 2011 e deri më 30 qershor 2013. Kjo kontratë është vazhduar, përkatësisht ripërtërirë deri më 3 prill 2015.
25. Më 3 mars 2015, përkatësisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës, parashtruesi i kërkesës e kishte njoftuar punëtorin se nuk do t’iu ofrohet kontratë e re e punës pas skadimit të kontratës ekzistuese me arsyetimin se kontrata nuk po iu vazhdohet me “[...] politikat e Bordit të Drejtorëve për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore”.
26. Më 5 mars 2015, punëtori ka parashtruar ankesë tek parashtruesi i kërkesës (punëdhënësi) lidhur me njoftimin për mosripërtëritjen e kontratës së punës, duke kërkuar që i njëjti të anulohet.
27. Më 18 mars 2015, parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e punëtorit.
28. Në një datë të paspecifikuar, punëtori i ishte drejtuar me ankesë Inspektoratit të Punës në Prishtinë, lidhur me vendimin për mospërtëritjen e kontratës së punës nga parashtruesi i kërkesës.
29. Më 1 prill 2015, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës në Prishtinë kishte miratuar ankesën e punëtorit dhe kishte urdhëruar parashtruesin e kërkesës që të zbatojë dispozitat e nenit 10.5 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive dhe nenin 71 të Ligjit të Punës.
30. Kundër këtij vendimi parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në shkallë të dytë, tek Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës në Prishtinë.
31. Në një datë të paspecifikuar, përmes Vendimit 05/2015, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës në Prishtinë kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë.
32. Në një datë të paspecifikuar, punëtori paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), ku kërkoi që të anulohet Njoftimi i 3 marsit 2015, i lëshuar nga parashtruesi i kërkesës dhe të

detyrohet parashtruesi i kërkesës që punëtorin t'a kthej në punë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Ndër të tjera, punëtori pretendoi që pozita e tij tek parashtruesi i kërkesës ka qenë e natyrës së përhershme dhe, për më tepër, njoftimi për mosvazhdimin e kontratës ishte në kundërshtim me nenin 10.5 të Marrëveshjes Kolektive e cila është në fuqi nga 1 janari 2015.

33. Më 12 janar 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit C. nr. 140/2015, kishte vendosur që: (i) ta aprovojë kërkesëpadinë e punëtorit si të bazuar dhe të anulojë njoftimin e punëdhënësit (parashtruesit të kërkesës) për mosripërtëritjen e kontratës së punës; (ii) ta obligojë punëdhënësin (parashtruesin e kërkesës) që t'a kthejë në punë punëtorin; (iii) t'ia paguaj shumat përkatëse punëtorit në emër të dëmit material; dhe (iv) të mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.
34. Në këtë aktgjykim, Gjykata Themelore konstatoi se, bazuar në nenin 10.5 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (MPKK), kontrata e punës në kohë të caktuar konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar nëse punëtori ka punuar pa ndërprerë mbi tri vite dhe në rastin konkret ai kishte punuar katër vite pa ndërprerje (përkatësisht nga 2 korriku 2011 e deri më 3 prill 2015). Sipas Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës, para se të shkëputte marrëdhënien e punës, është dashur të iniciojë procedurë të brendshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës "[...] ose nëse eventualisht ndërprerja e marrëdhënies së punës në kohë ta pacaktuar ka të bëjë me arsye teknike, ekonomike ose organizative, konform dispozitave të nenit 70 e lidhur me nenin 76 të LP-së, e paditura ka qenë e obliguar t'i harton programet si dhe t'i zbatojë këto dispozita të LP-së dhe përveç që të njoftojë paditësin një muaj para se t'ia ndërpresë marrëdhënien e punës, ka qenë e obliguar të njoftojë edhe sindikatën e të punësuarve për ndryshimin e planifikuar, duke bërë përpjekje për risistemimin e brendshëm të të punësuarve [...]".
35. Më 21 janar 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, të 12 janarit 2016, në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
36. Më 27 janar 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit Ac. nr. 887/16, kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata e Apelit potencoi se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare dhe ka dhënë shpjegime adekuate për një vendosje të këtillë, të bazuar në dispozitat përkatëse ligjore. Për sa i përket MPKK-së, Gjykata e Apelit konsideroi se "gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka mbështetur vendimin e saj në MPKK, e cila ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja kontestimore dhe se dispozitat e saj obligojnë palët në sektorin privat, publik dhe shtetëror".
37. Më 1 mars 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kishte

pretenduar se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë shkelur Ligjin e Punës, i cili parasheh që kontrata e punës për një periudhë më të gjatë se 10 vite konsiderohet si kontratë në kohë të pacaktuar. Ndërsa, gjykatat e shkallëve më të ulëta, sipas parashtruesit të kërkesës, ishin thirrur në dispozitën e nenit 10.5 të Marrëveshjes Kolektive e cila bie ndesh me Ligjin e Punës.

38. Më 19 tetor 2017, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Rev. nr. 98/2017, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke i vlerësuar vendimet e goditura si të drejta dhe duke vlerësuar se janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje.

39. Me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ndër të tjera, theksohet se “*parashtrimet [e revizionit] kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara [sepse] janë në kundërshtim me vet përmbajtjen e shkresave të lëndës, konkretisht njoftimin e të paditurit me shkrim të datës 3 mars 2015, për mospërtëritjen e kontratës së punësimit të paditësit dhe përgjigje në ankesë të të paditurit [...] nga të cilat prova rezulton se paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës në bazë të vendimit të kompanisë për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore, Ligjit të Punës dhe Marrëveshjes së Partneritetit Publiko-Privat [...]. I padituri në gjykatën e shkallës së parë nuk e ka paraqitur fare vendimin e Kompanisë për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore dhe Marrëveshjen për Partneritetin Publiko-Privat [...] me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të tij [...].*

*Në këtë çështje konkrete i padituri nuk i ka respektuar rregullat primare të procedurës dhe detyrimet e tij që gjykatës t’i prezantoj fakte, mbi të cilat e mbështet pretendimin e vet dhe nuk ka prezantuar prova, me të cilat do të kishte provuar bazueshmërinë e pretendimeve. Mosveprimi i paditësit në kuptim të dispozitës së nenit 7 të LPK-së nuk mund t’i vishte Gjykatës si lëshim i saj [...]”. Përkitazi me pretendimet e revizionit se paditësi (punëtori) ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të caktuar, Gjykata Supreme arsyetoi se: “*parashtrimet e tilla kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, për arsye se objekti i kërkesëpadisë së paditësit nuk është vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës në kohë ta pacaktuar por vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mospërtëritjen e kontratës së punës, i cili njoftim është marrë në kundërshtim me Ligjin e Punës, që është ligj themelor që rregullon marrëdhënien e punës në Kosovë*”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 98/2017, të 19 tetorit 2017, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe në nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës.

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në vendimin e saj. Sipas parashtruesit, si pasojë e mosarsyetimit të mjaftueshëm të vendimit i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31, 32 dhe 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi thekson se: “*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk*

ka arsyetim të mjaftueshëm, sidomos në lidhje me shkëljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore (errores in procedando) të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

42. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale (*errores in iudicando*) të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe Kontratës së Përgjithshme Kolektive. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se *“Gjykata Supreme bëri interpretim të gabuar të nenit 10.5 i Marrëveshjes kolektive, sepse ai nuk mund të zbatohet ndaj kompanisë Limak, ngase ajo nuk kishte një marrëveshje të shkruar me Sindikatën e Aeroportit, ashtu siç kërkohet nga Ligji i Punës”.*
43. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme, në këtë rast, fare nuk e trajtoi çështjen e zbatimit të Marrëveshjes Kolektive dhe, për më tepër, trajtoi çështje që asnjë palë nuk i ka ngritur, siç është neni 5.1 i Ligjit të Punës.
44. Parashtruesi pohon se mungesa e arsytimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme konsiston në atë se *“cili akt juridik kishte fuqinë më të madhe ligjore, Marrëveshja Kolektive apo Ligji i Punës, pasi Ligji i Punës nr. 03/L-212, neni 90 pika 5 thotë se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrime të përcaktuara me marrëveshje e tillë kolektive”.* Për më tepër, parashtruesi gjithashtu thekson se të gjitha instancat kanë zbatuar dispozita të ndryshme ligjore, me arsyetime të ndryshme lidhur me kërkesën e punëtorit për anulimin e njoftimit.
45. Lidhur me këtë, parashtruesi shprehet se Gjykata Supreme do të duhej të kishte marrë parasysh nenin 9.18 të MPPP-së, sipas së cilit parashtruesi i kërkesës merr për obligim t'i mbajë punëtorët në punë me afat prej 3 (tri) vitesh.
46. Si rrjedhojë, parashtruesi pretendon se me kthimin në punë të punëtorit është dëmtuar aspekti financiar dhe të drejtat e tij pronësore.
47. Parashtruesi gjithashtu citon Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese dhe pohon se *“aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate porse Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material”.*
48. Andaj, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme nuk i ka arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimet e tyre dhe nuk i kanë trajtuar çështjet e ngritura me aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.
49. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata ta shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe që çështja të kthehet në rigjykim.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 2

[Fusha e zbatimit]

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës.
3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët janë të punësuar tek punëdhënësit në territorin e Republikës së Kosovës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
4. Dispozitat e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për marrëdhëniet e punësimit brenda misioneve ndërkombëtare, misioneve diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja, Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare të vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin dhe organizatat ndërkombëtare qeveritare.

Neni 5

[Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit]

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

Neni 67

[Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:
[...]

1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

Neni 70

[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:
 - 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
 - 1.2. i punësuarin nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;
 - 1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një

vend pune tjetër, ta trajnojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:

1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe

1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

[...]

Neni 71

[Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës]

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej 6 (gjashtë) muaj deri në 2 (dy) vite punësim, 30 (tridhjetë) ditë kalendarike;

1.2. prej 2 (dy) deri në 10 (dhjetë) vite punësimi, 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike;

1.3. mbi 10 (dhjetë) vite punësim, 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Neni 90

[Marrëveshja Kolektive]

5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënësit dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive.

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës

Neni 2

[Fushëveprimi]

1. Dispozitat e MPKK, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje).

2. Dispozitat e MPKK vlejnë për nxënësit, studentët në aftësim profesional.

3. Dispozitat e MPKK vlejnë edhe për të punëdhënësit dhe të punësuarit me shtetësi të huaj, ose pa shtetësi të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës.

4. Dispozitat e MPKK nuk vlejnë për punëdhënësit, ose përfaqësuesit e tyre dhe të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre, të përcaktuar me nenin 2, paragrafin 4, të Ligjit të Punës në Kosovë.

Neni 3
[Aplikimi dhe përfshirja]

Dispozitat e MPKK aplikohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 4

1. Dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes.

2. Degët e sindikatave të veprimtarive joekonomike (shërbimet civile, publike dhe ndërmarrjet publike), lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre (ministritë përkatëse, atë të Administratës Publike, Arsimit, Shëndetësisë, etj), në pajtim me specifikat e tyre.

Neni 5

MPKK, vlen për të gjithë të punësuarit të cilët punojnë tek punëdhënësit, që kanë selinë në territorin e Kosovës.

Neni 10
[Kontrata e Punës]

1. Kontrata e Punës, lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit.

[...]

5. Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se 3 (tri) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar.

6. Kontrata e Punës, për punë dhe detyra specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë, brenda 1 (një) viti.

7. Të punësuarit, për punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor, ndërsa i takojnë të drejtat tjera të përcaktuara me ligj.

**Marrëveshja për Partneritet Publiko-Privat për Operimin dhe
Zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës**

9.18 [Përfundimi i Personelit]

“Partneri Privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat, dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara (ii) sipas

marrëveshjes së përbashkët, dhe (iii) pa kufizime pas përvjetorit të tretë (3) të datës së hyrjes në fuqi”.

Pranueshmëria e kërkesës

50. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

52. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

53. Fillimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, par.14).

54. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

55. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, e cila konteston aktet e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, përmes vendimeve të gjykatave të rregullta, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
56. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2), i Rregullores së punës, përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
57. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me Kushtetutë, përkatësisht e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete efektive juridike dhe mbrojtja e pronës.
58. Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës bien brenda fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës, gjegjësisht nenit 6 të KEDNJ-së dhe konsistojnë në argumentet e tij se: Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimin përkatës dhe se ka bërë zbatim të gabuar të dispozitave të Ligjit të Punës dhe Marrëveshjes Kolektive. Kjo pasi që, sipas parashtruesit të kërkesës, Marrëveshje Kolektive nuk mund të aplikohet për ta sepse nuk kishte një marrëveshje paraprake në mes të parashtruesit të kërkesës me Sindikatën (e Aeroportit).
59. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme (sikundër edhe gjykatat e shkallës më të ulët) nuk kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm se cili akt juridik kishte fuqinë më të madhe ligjore, Marrëveshja Kolektive apo Ligji i Punës. Për më tepër, parashtruesi gjithashtu pohon se të gjitha instancat kanë zbatuar dispozita të ndryshme ligjore, me arsyetime të ndryshme lidhur me kërkesën e punëtorit për anulimin e njoftimit.

60. Lidhur me pretendimet e parashtruesit, Gjykata vëren se në aktgjykimin e saj për revizion, Gjykata Supreme konstatoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm.
61. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se në këtë rast objekt i kërkesëpadisë nuk është vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës në kohë të pacaktuar, por vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mospërtëritjen e kontratës së punës, i cili sipas Gjykatës Supreme është në kundërshtim me Ligjin e Punës. Sipas Gjykatës Supreme, punëtorit nuk i është vazhduar kontrata e punës për arsye të planifikimit të resurseve njerëzore, i cili vendim për planifikimin e burimeve njerëzore nuk iu kishte prezantuar gjykatave të rregullta.
62. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes Kolektive apo Ligjit të Punës, për llogaritjen e kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme i kishte sqaruar parashtruesit se objekti i kërkesëpadisë është vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mospërtëritje të kontratës së punës.
63. Në këtë vazhdë, Gjykata Supreme arsyetoi se:
- “Parashtrime në revizion se aktgjykimi i shkallës së dytë është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, për faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të caktuar dhe nuk ka kaluar afati 10 vite që në kuptim të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, që marrëdhënia e punës së paditësit t’i trajtohet me kohë të pacaktuar [...] kjo gjykatë i shqyrtoj dhe si të tilla i refuzoi si të pabazuara, për arsye se objekti i kërkesëpadisë së paditësit nuk është vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës së paditësit në kohë të pacaktuar por vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mospërtëritjen e kontratës së punës, i cili njoftim është marrë në kundërshtim me Ligjin e Punës, që është ligj themelor që rregullon marrëdhënien e punës në Kosovë, ku është përcaktuar bazat dhe procedurat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së punëtorit të cilat procedura i padituri nuk i ka respektuar me rastin e ndërprerjes së punës së paditësit dhe për rrjedhojë mospërtëritja e kontratës së punës së paditësit është e kundërligjshme”.*
64. Për më tepër, Gjykata vëren argumentimin e Gjykatës Supreme se: “ [...] paditësit që nga themelimi i marrëdhënies së punës në vitin 2009, edhe pas koncesionimit i është vazhduar marrëdhënia e punës me kontratë me kohë të caktuar edhe pse vendi i punës ka qenë i natyrës së përhershme. Kontratat e këtilla sipas mendimit të kësaj Gjykate janë në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, ku afër 7 vite vazhdimisht paditësi mbahet në gjendje të pasigurtë juridike të marrëdhënies së punës, me vazhdimin e marrëdhënies së punës në kohë të caktuar, dhe në fund me një njoftim që nuk ka mbështetje ligjore paditësit i ndërprente kontratën e punës. Punëmarrësi nuk mund të heq dorë nga e drejta e punëtorëve, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të nenit 5 par 1 të Ligjit të Punës, ku parashihet se është i ndaluar qfarëdo diskriminimi në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e

punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës [...].

65. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme del jashtë kërkesës të revizionit dhe kërkesave të ligjit për të cilat ajo duhet të kujdeset zyrtarisht dhe trajton çështje që asnjë palë nuk i ka ngritur, siç është neni 5.1 i Ligjit të Punës.
66. Lidhur me pretendimin konkret (dhe në dritën e arsyetimeve kryesore të Gjykatës Supreme), Gjykata konsideron se parashtruesi nuk argumenton pse referimi i Gjykatës Supreme në nenin 5.1 të Ligjit të Punës ka shkaktuar shkelje të ndonjë të drejte kushtetuese të parashtruesit, përkatësisht pse ai referim ka ndikuar në epilogun e procesit gjyqësor në rastin në fjalë.
67. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, thirret në Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese, duke pohuar se *“aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate por se Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material”*.
68. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se rasti në fjalë dallon nga rasti konkret për arsyet si në vijim: (i) çështja e procedurës disiplinore ndaj punëtorit të parashtruesit, në rastin KI138/15, ishte trajtuar në mënyra të ndryshme nga gjykatat e rregullta; (ii) ishte e paqartë baza juridike me të cilën ishte zhvilluar procedura disiplinore; dhe (iii) kishte elemente kundërtë në vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta. Për më tepër, Gjykata e Apelit kishte zbatuar dhe kishte përdorur për arsyetim një Udhëzim Administrativ, i cili derivonte nga një Rregullore për Shërbyesit Civilë, e jo nga Ligji i Punës. Ky argument, edhe pse ishte i ngritur nga parashtruesi i kërkesës në atë rast, nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15, *Sharr Beteiligung GmbH*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017).
69. Në dritën e trajtimeve të mësipërme, Gjykata vë theksin në qëndrimin e saj të përgjithshëm se, parimisht, nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese Aktvendim për papranueshmëri, i 6 shtatorit 2017, *Driton Sylja*, KI78/16, paragrafi 59).
70. Vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe aplikimi i drejtë i ligjit është detyrë parësore dhe brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

71. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme (dhe gjykatave të shkallës më të ulët) nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
72. Si përfundim, Gjykata konsideron se e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e parashtruesit të kërkesës nuk i është shkelur nga vendimet e autoriteteve publike.
73. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente bindëse që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
74. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi